

# KUJDES!

- Mos harroni të kodoni grupin (A ose B) në fletëpërgjigjen e provimit. **Fletë-përgjigjet me grupin e pakoduar nuk vlerësohen.**
- Çdo pyetje ka vetëm një përgjigje të saktë. Nëse një pyetjeje i jepni dy përgjigje atëherë ajo pyetje do të vlerësohet si e gabuar.
- Përgjigja do të kodohet me laps. Në të kundërt kompjuteri nuk do ta lexojë.
- Përgjigjen e pyetjes do ta kodoni vetëm brenda rrethit siç është vepruar në shembullin e poshtëshënuar

Saktë  A  B  C  D

Gabim  A  B  C  D

- Bëni kujdes për të mos dalë jasht rrethit kur të kodoni përgjigjen.
- Mos bëni asnjë veprim mbi fletë përgjigjen e provimit si zhgarravitje, rrudhosje etj.
- Mos iu përgjigjini pyetjeve për të cilat nuk jeni të sigurtë. **Kujdes! 3 përgjigje gabim fshijnë një të saktë.**
- Mos qëndroni shumë tek pyetjet që nuk zgjidhni dot, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për t'iu përgjigjur pyetjeve të tjera.
- Koha e provimit është **150 minuta**. Shfrytëzoni deri në fund kohën e provimit. Në qoftë se ju tepron kohë, bëjini dhe një kontroll testit.
- Përgjigjet e pyetjeve që ndodhen në këtë libërth, do të kodohen në fletë-përgjigje në pjesën ku shkruan "PERGJIGJET".
- Në provim **ndalohet** mbajtja ose përdorimi i celularit dhe makinës llogaritëse.
- Kodoni me kujdes preferencat tuaja për shkollat në të cilat dëshironi të studioni. Rezultatet dhe bursat do të shpallen sipas preferencave të bëra.

Shkolla	Kodi
"Mehmet Akif" e Mesme - Vajza në Tiranë (me konvikt)	<b>01</b>
"Mehmet Akif" e Mesme - Djem në Tiranë (me konvikt)	<b>02</b>
"Turgut Özal" 9-Vjeçare dhe e Mesme në Tiranë (me konvikt)	<b>03</b>
"Hasan Riza Pasha" 9-Vjeçare dhe e Mesme në Shkodër (e mesme me konvikt)	<b>04</b>
"Turgut Özal" 9-Vjeçare dhe e Mesme në Durrës (klasat 9-12 me konvikt)	<b>05</b>

*Suksese!*

MATEMATIKE 9-A

1.

$$\frac{1}{x-2} - \frac{1}{x+2} = 1 \Rightarrow (1+x^2) = ?$$

- A) 8
- B) 9
- C) 10
- D) 12

2.

$$\frac{2a-1}{a-\frac{1}{2}} = ?$$

- A) 4
- B) 2
- C) a
- D)  $\frac{1}{2}$

3.

$a+b=12$  dhe  $a \cdot b=10$ . Gjeni vlerën e  $a^2 + b^2$ .

- A) 32
- B) 48
- C) 64
- D) 124

4.

$$\frac{1-x}{\sqrt{x+1}} = ?$$

- A)  $\sqrt{x-1}$
- B)  $1-\sqrt{x}$
- C)  $\sqrt{x}-1$
- D)  $x-\sqrt{x}$

5.

$$x^2 + y^2 - 4 - 2xy = 0 \Rightarrow |x-y| = ?$$

- A) -3
- B) -1
- C) 1
- D) 2

6.

$$\frac{(-2)^3 \cdot (-3)^2}{(-3^2)} = ?$$

- A) -8
- B) 8
- C) -27
- D) 27

7.

$$\frac{10}{\sqrt{5}} - \frac{8}{\sqrt{20}} - \sqrt{\frac{1}{5}} = ?$$

A)  $5\sqrt{5}$

B)  $\sqrt{5}$

C)  $\frac{1}{5}$

D)  $\frac{1}{\sqrt{5}}$

8.

$$a = \frac{30}{40}, b = \frac{30}{44}, c = \frac{33}{40}$$

Cila nga rënditjet e mëposhtme është e vërtetë?

A)  $c < b < a$

B)  $c < a < b$

C)  $b < c < a$

D)  $b < a < c$

9.

$$x < -1 \text{ dhe } 2x + |x+1| = -6. \text{ Gjeni } x.$$

A)  $-\frac{7}{3}$


B)  $-7$

C)  $-6$

D)  $-5$

10.

Një karton në formë katrori ngjyroset si në figurën e parë (fig.1). Pastaj kartoni rrotullohet rreth qendrës së tij në drejtimin e shigjetës gjersa përftohet figura e dytë (fig.2). Për ta realizuar këtë, minimumi sa grade duhet rrotulluar kartoni?



A) 60

B) 90

C) 120

D) 180

11.

Gjeni bashësinë e zgjidhjeve të inekuacionit

$$2(x-1) \leq -1 + 3(x+2).$$

A)  $x \leq 7$

B)  $x \geq -7$

C)  $x \leq -1$

D)  $x \geq -3$

12.

$$\sqrt{2015 \cdot 2017 + 1} = ?$$

A) 2014


B) 2015

C) 2016

D) 2017

13.


$|AB|=|BE|$ ,  $\angle(ACD)=140^\circ$ ,  
 $\angle(EBC)=10^\circ$ . Gjej  $\angle(A)$ .



- A)  $40^\circ$
- B)  $50^\circ$
- C)  $60^\circ$
- D)  $80^\circ$

14.

$[AB] \perp [BC]$ ;  $|CD|=4 \text{ cm} \Rightarrow |AD|=x=?$




- A) 15
- B) 18
- C) 20
- D)  $\sqrt{185}$

15.

ABCD është drejtkëndësh.  
 $|AE|=6 \text{ cm}$ ;  $|EB|=|BC|=b \text{ cm}$ .


Gjeni sipërfaqe e drejtkëndëshit ABCD.



- A) 30
- B) 32
- C) 34
- D) 36

16.

Në një trapez dybrinjëshëm,  $|AD|=|BC|=5 \text{ cm}$ ,  $|DC|=6 \text{ cm}$ ,  $|AB|=10 \text{ cm}$ . Sipërfaqja e trapezit është:




- A)  $6\sqrt{21}$
- B)  $16\sqrt{5}$
- C)  $8\sqrt{21}$
- D)  $12\sqrt{5}$

17.

ABCDEFGH është kuboid . Sipërfaqja  
 $S(ABCD) = 2\text{ cm}^2$ ,  $S(GHBA) = 6\text{ cm}^2$ ,  
 $S(HBCF) = 3\text{ cm}^2$ .

Gjeni vëllimin e kuboidid.



- A) 6
- B) 9
- C) 18
- D) 36

18.

Genci, Bora dhe Mirela do të ndajnë mes tyre 550 Lekë sipas këtyre kushteve:


- i) Genci do të marrë 100 Lekë më shumë se Bora.
- ii) Bora do të marrë dyfishin e Lekëve të Mirelës.

Gjeni sa Lekë do të marrë Bora.

- A)145
- B)150
- C)160
- D)180

19.

$[CA] \perp [AB]$ ;  $[AD] \perp [BC]$ ;  $|AC| = 5\text{ cm}$ ;  $|AB| = 12\text{ cm}$   
 $|AD| = h = ?$



- A)  $\frac{70}{12}$
- B)  $\frac{65}{12}$
- C)  $\frac{60}{13}$
- D)  $\frac{55}{7}$

20.

Në një ndërtesë, numri i dritareve të çdo kati është sa gjysma e numrit të kateve të ndërtesës.

Nëqoftëse ndërtesa ka gjithsej 128 dritare, sa kate ka ajo?


- A)8
- B)16
- C)18
- D)20

# UDHEZIM


PER MENYREN E ZGJIDHJES SE PYETJEVE LOGJIKE

**Shembull :**


Cila është pllaka që mungon?




A)




B)



C)




D)




**Udhëzim:** Duke u bazuar në dy rreshtat e pare vërejmë se shigjetat tregojnë vetëm 3 drejtime (djathtas, majtas dhe poshtë). Nga lartë poshtë numri i pllakave rritet me nga një shigjetë. Pra pllaka që mungon duhet të ketë 3 shigjeta me drejtim poshtë, ndryshe nga dy pllakat e tjera. Prandaj e vetmja përgjigje e saktë është **D**.

21.


Cila figurë vjen në vend të pikëpyetjes?




A)




B)



C)



D)



22.



$$\begin{array}{r} \text{KL} \\ + \text{LK} \\ \hline 99 \end{array} \quad \begin{array}{r} \text{KL} \\ - \text{LK} \\ \hline 9 \end{array} \Rightarrow K \times L = ?$$

- A) 14    B) 18    C) 20    D) 24

23.

Të tre figurat e dhëna në rreshtin e parë tregojnë të njëjtin kub.

Në rreshtin e dytë jepet hapja në plan e këtij kubi. Cilat faqe të kubit tregojnë X dhe Y?



X    Y

- A)    c    d
- B)    d    a
- C)    a    d
- D)    c    a

24.




x	a	b	c
a		8	
b			12
c	6		

$a > 0$      $b > 0$      $c > 0$   
 $a = ?$

- A) 2    B) 3    C) 4    D) 6

25.


Cili numër duhet të vijë në vend të pikëpyetjes?



- A) 12    B) 15    C) 16    D) 24

26.


Cili numër duhet të vijë në vend të x?



- A) 42    B) 48    C) 56    D) 64


27.

Cila nga figurat e dhëna është e ndryshme nga të tjerat?





28.

Cila nga figurat e dhëna është e ndryshme nga të tjerat?



29.

Cila figurë vjen në vend të pikëpyetjes?



30.

Gjej rezultatin e veprimit.

$$1 \blacksquare 3 = 2$$

$$3 \blacksquare 5 = 12$$

$$5 \blacksquare 7 = 30$$

$$6 \blacksquare 9 = ?$$

- A) 39    B) 48    C) 52    D) 54



61. E përbashkëta midis miteve, përrallave, legjendave, fabulave, është:

- I përkasin gjinisë dramatike.
- Janë forma të përbëra të rrëfimit.
- Shpjegimi popullor mbi origjinën e botës dhe të popujve.
- Janë forma elementare të rrëfimit.

62. Është shkruar nga Mitrush Kuteli, pjesa:

- “Ai...”
- “Pas betejës”
- “Rinë Katerinëza”
- “Jesminë”

63. Trajton temë të ngjashme me poemën “Kënga e sprasme e Balës”, romani:

- “Prilli i thyer”
- “Krastakraus”
- “Jesmine”
- “Dranja”

64. Janë shkruar nga Jeronim de Rada veprat:

- “Këngët e Milosaos”, “Serafina Topia”, “Flamuri Arbrit”
- “Juvenilja”, “Andrra e jetës”, “Vaji i bylbylit”, “Liria”
- “Bagëti e bujqësi”, “Lulet e verës”, “Histori e Skënderbeut”
- “Kronikë në gur”, “Prilli i thyer”, “Kështjella”

65. Personazhet e Gjorgut, Dianës dhe Besianit, i gjejmë në veprën:

- “Prilli i thyer”
- “Ne të tre”
- “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”
- “Krastakraus”

66. Kemi një rrëfim të ndjerë, i cili zhvillohet midis mësuesit dhe nxënëses së tij, në pjesën:

- “Rinë Katerinëza”
- “Jesminë”
- “Ne të tre”
- “M’at anë gardhit asgja të re”

67. Në vargun: “Ku ujëra t’amullt moçalorë harbohen.”, kemi figurat letrare:

- simbol dhe epitet
- epitet dhe metaforë
- krahasim dhe metaforë
- apostrof dhe metaforë

68. Është poemë baritore (idilike):

- “Himni i flamurit”
- “Bagëti e Bujqësi”
- “Këngët e Milosaos”
- “Bregu i mollës”

69. Tregimi “Kumbulla përtej murit”, bën pjesë në vëllimin me tregime:

- “Hija e maleve”
- “Tregtar flamujsh”
- “Pasqyrat e Narcizit”
- “Gjurmat e stinëve”

70. Vargjet: “Përpyetë pri-e Shqipërinë,  
/përlintj'a shpirtin dhe fuqinë, /diell për  
vllanë, yrnek për fqinë/ Për botën ëndr' e  
qjell i ri.”, janë shkruar me rimën:

- a. ABAB
- b. ABBA
- c. AAAB
- d. AABB

71. Gjeni fjalën e shkruar gabim:

- a. E djelë
- b. Qiell
- c. Diellor
- d. Miell

72. Cila nga fjalitë e mëposhtme është fjali e përbërë:

- a. Deri nesër kjo punë duhet të ketë përfunduar.
- b. Kështu do të kishte vepruar dhe ai.
- c. Ketri mund të mbahet mirë në një kafaz.
- d. Ky është viti i dytë që janë rritur eksportet.

73. Në fjalinë: "Vjeshta sikur hidhte mbi  
çatitë e shtëpive ar dhe argjend.",  
gjymtyrët homogjene kryejnë funksionin  
e:

- a. rrethororit të vendit
- b. përcaktorit me drejtim
- c. kundrinorit të drejtë
- d. përcaktorit kallëzuesor

74. Në cilën nga fjalitë e mëposhtme "u-ja"  
është përdorur si pjesëz e formës  
joveprore:

- a. U ra libri nga dora.
- b. I thirra dhe u tregova gjithçka.
- c. Njerëzve u dukej kjo gjë shumë e çuditshme.
- d. Ne u ngritëm në këmbë.

75. Rretho alternativën e saktë: Në cilën nga  
fjalitë e mëposhtme kemi trajtë të  
shkurtër të rasës dhanore, numri njëjës:

- a. E mori rrëmbimthi librin.
- b. Zëri i tyre kumboi kudo.
- c. Njerëzve u dukej kjo gjë shumë e çuditshme.
- d. Të gjithë i erdhëm në ndihmë.

76. Dallo cila nga fjalitë e mëposhtme është  
me vetë të përgjithësuar:

- a. Ç'unazë e bukur!
- b. S'është për t'u tallur.
- c. Fliste tërë kohës për vete.
- d. Duaje atdhenë si shqiponja folenë.

77. Cili nga emrat femërorë të mëposhtëm  
është shkruar gabim:

- a. gjysmë
- b. basmë
- c. gjysëm
- d. dasmë

**78.** Në cilën prej fjalive kemi ndajfolje:

- a. Djali i qëndroi pranë nënës.
- b. Makina e fundit ishte më e shpejta.
- c. Afrohu, ulu më pranë.
- d. Në oborr kishte disa nxënës.

**79.** Në cilën fjali, folja “*jam*”, ka kuptim ndihmës:

- a. Ju keni për të mësuar këtu, ndaj mund të pyesni.
- b. Ti ke qenë gjithmonë i aftë për t’i sqaruar mirë shokët.
- c. Ti je i zgjuar dhe e kupton këtë.
- d. Vajza ka ndenjur e menduar gjithë ditën për fjalët që i janë thënë.

**80.** Cila nga fjalitë e mëposhtme është fjali e përbërë me bashkërenditje dhe nënrenditje:

- a. Ndeshja finale do të zhvillohet nesër prandaj jemi të emocionuar.
- b. Treni nuk erdhi në kohën e duhur, sepse kishte vështirësi gjatë rrugës.
- c. Harroje këtë ndodhi dhe vazhdo punën që ke nisur.
- d. Ndërsa miqtë po vinin, të gjithë dolëm te dera.